

StarthilfePlus – mbështetje plotësuese e riintegrit në vendin e destinacionit

në rast të kthimit vullnetar me REAG / GARP

Albanisch/ Albanian
Informationen zur
Reintegrationsunterstützung

Përveç kthimit vullnetar me REAG/GARP ju mund të aplikoni për njëren prej ndihmave vijuese për riintegrim

A: Mbështetje financiare në vendin e destinacionit (ndihma e 2-të për fillim të ri)

Në rast të një kthimi vullnetar në vendet e mëposhtme të destinacionit: Afganistani, Egjipti, Algjeria, Etiopia, Bangladeshi, Benini, Burkina Faso, Kina, Bregu i Fildishtë, Republika Demokratike e Kongos, Eritrea, Gambia, Gana, Guinea, Guinea-Bisau, India, Iraku, Kameruni, Kenia, Mali, Maroku, Mongolia, Nigeri, Nigeria, Pakistani, Federata Ruse, Senegali, Sierra Leone, Zimbabveja, Sri Lanka, Sudani, Togo, Tunezia, Vietnami.

- Përveç përfitimeve të REAG/GARP ju mund të merrni një mbështetje të mëtejshme financiare: si individ në vlerë prej 1.000 EUR dhe si një familje në vlerën prej 2.000 EUR.
- Misioni i IOM-it e paguan ndihmën e 2-të për fillimin e ri gjashtë deri në tetë muaj pas largimit vullnetar të Gjermanisë në vendin e destinacionit.

B: Mbështetje për riintegrim në fushën e banimit

Në rast të një kthimi vullnetar në vendet e mëposhtme të destinacionit: Armenia, Azerbajxhani, Irani, Libani, Taxhikistani, Turqia

- Përveç përfitimeve të REAG/GARP ju mund të merrni si një individ deri në 1.000 EUR dhe si një familje deri në 3.000 EUR si përfitime materiale.
- Me këto përfitime materiale mund të mbulohen p.sh. kosto për qiranë, punime ndërtimore dhe rinovimi ose për pajisjet themelore për kuzhinë dhe/ose banjën.
- Lajmërohuni brenda katër javësh pas largimit vullnetar me telefon ose përmes e-mailit tek misioni i IOM-it në vendin e destinacionit, për të akorduar mbi formën konkrete të mbështetjes dhe procedurën e mëtejshme.

C: Mbështetja për riintegrimin e personave të toleruar për një kohë të gjatë

Në rast të një kthimi vullnetar në vendet e mëposhtme të destinacionit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia Veriore, Mali i Zi, Serbia, Gjeorgji, Moldavi, Ukrainë. Vlen vetëm për personat të cilët tolerohen të paktën prej dy vitesh në Gjermani.

- Ju merrni nga misioni i IOM-it në vendin e destinacionit një ndihmë të njëhershme financiare në shumën prej 500 EUR për person.
- Përveç kësaj, ju mund të merrni përfitime të arsyeshme dhe të nevojshme materiale nga fushat e mëposhtme:
-> **Shpenzime për banesën deri në 1.000 EUR për individë dhe deri në 2.000 EUR maksimumi për familje.**
-> **Shpenzime mjekësore deri në 1.500 EUR për individë dhe deri në 3.000 EUR për familje.**
- Lajmërohuni brenda katër javësh pas kthimit me telefon ose përmes e-mailit tek misioni i IOM-it në vendin e destinacionit, për të akorduar mbi formën konkrete të mbështetjes dhe procedurën e mëtejshme.

Si të aplikoni për mbështetjen për riintegrim?

Nëse ju keni vendosur për largimin vullnetar, atëherë ju bëni një kërkesë në një qendër të këshillimit për kthimin për mbështetjen e riintegrit brenda aplikimit tuaj për REAG/GARP. Në rast të një largimi vullnetar, ju duhet të nënshkruani se ju e tërhiqni kërkesën tuaj për azil dhe hiqni dorë nga mjete ligjore. Vendin më të afërt të këshillimit për kthimin ju e gjeni: www.ReturningfromGermany.de/sq/centres

Ku merrni informacione të mëtejshme?

Lëreni të këshilloheni në mënyrë individuale në një qendër këshillimi për kthimin në afërsinë tuaj. Më shumë informacione gjeni nën www.ReturningfromGermany.de/sq/programmes/

Nuk ka asnjë të drejtë ligjore për mbështetje financiare në rast të kthimit vullnetar.